



DEKLARATË PËR MEDIA: Misioni për vëzhgimin e zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian publikon raportin përfundimtar me 19 rekomandime; nevojitet vullnet i vërtetë politik për të forcuar institucionet demokratike

Prishtinë, 15 maj 2025 – Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian (EU EOM) në Kosovë publikoi sot raportin përfundimtar mbi zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025. **Shefja e Misionit, Nathalie Loiseau, anëtare e Parlamentit Evropian**, tha: "Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 në Kosovë ishin konkurrese dhe të mbajtura sipas një kornize të re ligjore të hartuar për të forcuar transparencën dhe besimin. Megjithatë, procesi nxori në pah gjithashtu sfida të rëndësishme organizative, diskurs politik të polarizuar dhe fusha ku reformat janë ende të nevojshme."

Në raportin e tyre përfundimtar, EU EOM thekson se, përderisa dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e organizuar mirë dhe fushata dinamike, procesi vuajti nga përgatitja e pamjaftueshme nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vonesat në nxjerrjen e rezultateve dhe politizimin e institucioneve kryesore. Komisioni i Pavarur i Medias (KPM) dështoi të sanksiononte shkeljet në media. Përderisa peizazhi mediatik mbetet i larmishëm, ka ndarje të thella etnike, dhe u bënë vetëm përpjekje të kufizuara për të nxitur dialog ndërmjet komuniteteve. Disa media private treguan shenja politizimi. Gjithashtu vazhdojnë të mbeten shqetësimet në lidhje me sfidat me të cilat përballet transmetuesi publik.

Shefja e Misionit Nathalie Loiseau theksoi: "Rekomandimet janë udhërrëfyes për forcimin e institucioneve demokratike në Kosovë. Ekziston nevoja për vullnet të vërtetë politik dhe dialog kuptimplotë nga të gjithë aktetë zgjedhore për t'i zbatuar ato me sukses. Bashkimi Evropian mbetet i përkushtuar për të mbështetur Kosovën në këtë proces."

Edhe pse korniza ligjore ofron bazë të shëndoshë për zgjedhje demokratike, zbatimi i saj nxori në pah paqartësi që kërkojnë sqarime legislative. Ligji i ri zgjedhor prezantoi reforma të mirëpritura, mirëpo efektiviteti i tij u minua nga mungesa e përgatitjes dhe mangësitë operative.

Raporti përfundimtar ofron 19 rekomandime, duke përfshirë gjashtë rekomandime prioritare të cilat synojnë forcimin e proceseve zgjedhore të Kosovës. Këto janë:

- 1. Të forcohen garancitë ligjore në lidhje me anëtarësinë dhe sjelljen e zyrtarëve zgjedhorë**, për të siguruar paanshmërinë dhe pavarësinë e administratës zgjedhore.
- 2. Të kufizohen dhe specifikohen më tej përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretariatit të KQZ-së dhe komisioneve komunale zgjedhore** për të decentralizuar vendimmarrjen e administratës zgjedhore aty ku është e përshtatshme dhe për të siguruar që operacionet e saj të jenë efikase dhe me kohë.
- 3. Të bëhet një auditim gjithëpërfshirës i pavarur i listës së votuesve**, duke përfshirë përmes analizës së brendshme të proceseve të regjistrimit dhe testimit statistikor dhe në terren, në konsultim me palët përkatëse të interesit për të adresuar shqetësimet mbi saktësinë e tyre dhe për të rritur besimin e publikut.
- 4. Të prezantohen përkufizime të qarta ligjore të termave kyç**, përfshirë ato që lidhen me gjuhën nxitëse dhe përkufizimin e një 'mbështetësi të subjektit politik' **brenda procesit zgjedhor. Të vendosen kritere të qarta për përcaktimin e gjobave proporcionale të zbatueshme për shkeljet e Kodit të Mirësjelljes nga subjektet politike.**



EUROPEAN UNION
ELECTION OBSERVATION MISSION

KOSOVO PARLIAMENTARY ELECTIONS
9 February 2025

5. Të emërohen me kohë të gjithë anëtarët e KPM-së përmes një procesi përzgjedhës konkurrues dhe transparent.
6. Të krijohet një sistem i besueshëm dhe transparent i menaxhimit të rezultateve me procedura të qarta dhe të verifikueshme për të siguruar përpunimin e saktë të të dhënave të rezultateve. Të sigurohet qasje e shpejtë në rezultatet preliminare, duke përfshirë të gjitha të dhënat përkatëse, si p.sh. pjesëmarrja e votuesve, votat e vlefshme dhe të pavlefshme, si dhe formularët e rezultateve të skanuara për vendvotim.

Me ftesë të autoriteteve të Kosovës, EU EOM operoi në Kosovë nga 8 janari deri më 27 shkurt 2025, dhe iu bashkua një delegacion për vëzhgimin e zgjedhjeve nga Parlamenti Evropian. EU EOM dërgoi gjithsej 104 vëzhgues nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, si dhe nga Kanadaja, Norvegjia dhe Zvicra.

Raportin final me listën e plotë të rekomandimeve: <https://www.eeas.europa.eu/eom-kosovo-2025>

Për kërkesa nga mediat, ju lutemi kontaktoni: Emilia Hinkkanen, Zyrtare për Media, emilia.hinkkanen@eueomkosovo2025.eu, +383 45 536 911